



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE

MUNDËSI *... më shumë se kudo*



Studime universitare 2008 / 09

Përmbajtja


Fjala e rektorit	3
Studimet në UEJL	4
Fakultetet	11
Fakulteti i Administrimit të Biznesit	12
Fakulteti i Drejtësisë	13
Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore	14
Fakulteti i Administratës Publike dhe Shkencave Politike	17
Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit	20
Cilësia në UEJL	22



Të dashur studentë të ardhshëm!

UEJL është institucion i ri bashkëkohor edukimi me cilësi tanimë të dëshmuar. Universiteti u themelua në vitin 2001, si universitet i parë "privat-publik jofitimprurës" në rajon dhe që në fillim arriti të shndërrohet në "model të arsimimit të lartë në rajon", duke ofruar 15 programe cilësore universitare të akredituara, në pajtim me trendet ndërkombëtare, Deklaratën e Bolonjës dhe sidomos kërkesave të tregut lokal dhe ndërkombëtar të punës, të konfirmuara nga numri i madh i punësimeve të të diplomuarve tanë.

Qëllimi i Universitetit është që të përshtatet me praktikat më të mira evropiane të cilësisë së kontrollit të njohurive, vlerësimit dhe përgjegjësisë. Universiteti i zhvillon programet studimore dhe mekanizmat për sigurimin e cilësisë, që të garantojë përshtatshmërinë me procesin e ndërtimit të Hapësirës evropiane të arsimit sipëror dhe me institucionet tjera të Deklaratës së Bolonjës.



Universiteti promovon barazi, trajtim të drejtë dhe gjithëpërfshirës, ashtu që të gjithë studentët të kenë mundësi për ta arritur potencialin e tyre maksimal dhe të jenë të suksesshëm. Ne, vlerësojmë diversitetin etnik, kulturor dhe gjuhësor të studentëve tanë dhe punojmë që ta përdorim këtë diversitet për të rritur përvojën studimore të secilit student.

Viteve të fundit kemi pasur një sërë zhvillimesh të reja dhe mjaft interesante në UEJL. Njëra prej tyre është zgjerimi i infrastrukturës së Teknologjisë Informative (TI) me disa veçori të reja (e-Service, Angel, eGrading), për të mbështetur mësimdhënien në UEJL. Universiteti është kampion i padiskutueshëm në rajon për përdorimin e sistemeve të rrjeteve elektronike, që u mundësojnë studentëve dhe stafit qasje on-line në informatat relevante për studime (punën e tyre), në çdo kohë, duke shfrytëzuar ndonjë nga 700 kompjuterët në qytezë ose nga interneti në shtëpitë e tyre.

UEJL ka një numër të madh të stafit ndërkombëtar të kyçur në procesin e mësimdhënies. Këta, së bashku me stafin e shquar akademik vendorë, në mënyrë konstante mbështeten përmes programit ambicioz për zhvillimin e stafit dhe qasjes së shëndoshë për sigurimin e cilësisë.

Pra, nëse e shfletoni këtë broshurë për një program universitar, i cili do të rrisë zhvillimin tuaj personal dhe perspektivën e së ardhmes suaj, unë jam mëse i sigurt se mundësitë që ofrohen nga UEJL do t'ju mundësojnë që t'i pasuroni qëllimet e juaja akademike, profesionale dhe jetësore më shumë se çdokund tjetër.

Shpresojmë se së shpejti do të kemi mundësi që t'ju urojmë mirëseardhje si studentë në UEJL dhe shpresojmë se edhe Ju do të merrni pjesë aktive në gdhendjen e së ardhmes sonë.

Akademi Alajdin Abazi
Rektor i UEJL-së

Studimet në UEJL

Fakultetet & Programet universitare

- **Fakulteti i Drejtësisë**
- **Fakulteti i Administrimit të Biznesit**
- **Fakulteti i Administrimit Publik dhe Shkencave Politike**
 - Administratë Publike
 - Shkenca Politike
 - Punë dhe Politikë Sociale
- **Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore**
 - Shkencat Kompjuterike
 - Teknologjitë e Informimit dhe Komunikimit (Inxhinieria Kompjuterike)
 - Informatika e Biznesit
- **Fakulteti i Gjuhëve, Kulturës dhe Komunikimit**
 - Gjuhë dhe Letërsi Shqipe
 - Gjuhë Angleze me Studime
 - Gjuhe Gjermane me Studime
 - Gjuhë dhe Studime Europiane - drejtimi Frengjisht
 - Gjuhë dhe Studime Europiane - drejtimi Gjermanisht - Shqip
 - Përkthim dhe Interpretim (Shqip - Maqedonisht)
 - Shkencat e Komunikimit

Që nga formimi i tij në vitin 2001, UEJL ka hyrë në kategorinë e universiteteve më të mira dhe më inovativ në rajon. UEJL ka një reputacion të shquar ndërkombëtar për mësim cilësor dhe ju ofron mundësi që të jeni pjesë e një përvoje unike dhe moderne e edukimit, për t'u pajisur dituri dhe aftësi të nevojshme profesionale që të keni sukses në tregun profesional të punës.

Ne, në UEJL, besojmë se roli ynë është që t'i ndihmojmë studentët tanë për të arritur maksimumin e potencialit të tyre, që të kenë sukses. Kjo, është arsyeja pse programet tona janë të zhvilluara. Sidomos, duke pasur parasysh nevojat e juaja dhe në vazhdimësi u janë përshatur kërkesave të tregut të punës përmes bashkëpunimit tonë të vazhdueshëm me punëdhënësit.

Premtimi ynë është se do të bëjmë gjithçka që është e mundur për t'u ofruar dituri dhe aftësi profesionale, të cilat do t'ju ndihmojnë që të keni sukses në mjedisin konkurrues global.

Universiteti ynë ofron një zgjedhje të gjerë të programeve universitare 3 vjeçare, me mundësi për studim të rregullt, por edhe disa programe me mundësi për studime me korrespondencë.

Të gjitha programet e ofruara në UEJL janë modulare dhe ndjekin sistemin e kredive ECTS (European Credit Transfer System), gjë që i bën diplomat e UEJL-së të pranuar gjërësisht në sferën akademike dhe profesionale ndërkombëtare.

Studimet universitare në UEJL bazohen në sistemin 3+2+3, që do të thotë se çdo program studimor mund të plotësohet me studime të specializuara pasuniversitare (master), të cilat zgjasin 2 vite dhe më pas me studime të doktoratës për një kompletim të njohurive brenda një fushe të caktuar.

Duke e pasur parasysh përshtatjen ndaj tregut të punës dhe reformat në arsimin e lartë sipas modelit 3+2 dhe me qëllim që të diplomuarve tanë t'u japim shanse për inkuadrim në suaza të sistemit aktual të punësimit jemi në fazën e përgatitjes edhe të opsionit 3+1, të studimeve deridiplomike, që do të mund të pasohet me magjistraturë njëvjeçare.

Një përshkrim më të detajuar të programeve universitare e keni në faqet vijuese të broshurës, ose vizitoheni ueb faqen e universitetit www.seeu.edu.mk.

Sigurimi i cilësisë

Të gjitha programet e ofruara nga UEJL, janë të akredituara nga Bordi i akreditimit i Republikës së Maqedonisë dhe cilësia e programeve është nën një kontroll të vazhdueshëm nga ana mekanizmave për sigurim të cilësisë, të cilët përfshijnë një program ambicioz për zhvillim të stafit, observim të mësimdhënësve dhe shumë çështje të tjera.





Mësimdhënia, mësimnxënia dhe vlerësimi

Të studiuarit në universitet mund të jetë punë atraktive, shpërblyese dhe sfiduese. Ju do të studioni ide të reja dhe magjepsëse që mund të jenë shumë më ndryshe nga ato që i keni mësuar në shkollë të mesme. Në UEJL, qëllimi ynë është që ju të jeni të kënaqur me lëndët tuaja, të fitoni përvojë në të menduarit ndryshe dhe të dilni me dituri dhe shkathtësi që do t'ju mundësojnë pushtimin e së ardhmes suaj.

Ne, jemi të përkushtuar për t'ju ofruar njohuri cilësore, duke shfrytëzuar një kombinim të metodave tradicionale me ato më inovative të mësimdhënies, si p.sh. mësimi interaktiv, mësimi elektronik (e-learning) dhe kështu me radhë.

Ligjëratat luajnë rol vendimtar në mësimdhënie, duke i vendosur temat dhe çështjet më të rëndësishme të lidhura me lëndën, përderisa seminarët dhe ushtrimet sigurojnë strukturën për sqarim më të detajuar dhe analizë, duke ofruar mundësi për analizë dhe diskutim në grupe të vogla me mësimdhënësin dhe këmbimin e ideve.

Në UEJL aplikohet një gamë e gjerë metodash për vlerësim, të cilat janë të dizajnuara në atë mënyrë që t'ju krijojnë mundësitë më të mira për të demonstruar aftësitë e juaja. Këtu përfshihen provimet me shkrim, me gojë, projektet/punimet seminarike, pjesëmarrja aktive etj. Si universitet i vetëm në rajon, notat shpallen on-line përmes sistemit "e-Grading". Kjo, u mundëson studentëve që brenda disa sekondave pas shpalljes së notave nga ana e instruktorit përmes portalit "eServices", t'i shohin ato on-line.


Mësimi elektronik (e-learning) - Angel

E-learning është një pjesë e rëndësishme e përvojës akademike në UEJL dhe ne jemi të përkushtuar që ta inkurajojmë zhvillimin e mëtutjeshëm të saj. Pothuajse të gjitha lëndët janë të mbështetura nga burimet on-line përmes sistemit "Angel", duke iu mundësuar studentëve qasje tek materialet dhe detyrat, dorëzimin e projekteve/detyrave dhe komunikim me profesorët, në çdo kohë, në ndonjërin nga 450 kompjuterët që janë në dispozicion për studentët në qytezë ose përmes internetit në shtëpi.

Stafi akademik

Një gjë me ndikim në përvojën akademike të studentëve që më së shumti e dallon UEJL-në nga universitetet tjera në rajon është personeli akademik. Përveç një numri të madh të profesorëve eminentë nga rajoni, në Universitet janë të inkuadruar edhe një numër i gjerë i shkencëtarëve/profesorëve ndërkombëtarë, të cilët vijnë nga vende të ndryshme të botës, duke sjellë me vete jo vetëm përvojën e tyre akademike në UEJL, por edhe kulturën e tyre dhe të menduarit ndryshe. Kjo veçori kontribuon dhe shton perspektivën globale dhe multikulturore të programeve tona, duke i bërë ato më të përshtatshme për mjedisin global të punës.

Një veçori tjetër e dukshme e profesorëve tanë dhe e politikës së universitetit në lidhje me stafin është edhe përkushtimi për të siguruar mësim cilësor dhe një arritje të theksuar të nivelit akademik.



Leonora Kaliqi,
studente,
viti i III -të
Administrim Biznesi

"Ajo që më pëlqen më së shumti është padyshim përgatitja profesionale e profesorëve. Kam pasur fatin që gjatë tre viteve të fundit të ndjek lëndë që ligjërohen nga profesorë eminentë nga vendi, të cilët përveç njohurive të mirëfillta teorike, kanë edhe përvojë shumëvjeçare praktike. Kjo më ka mundësuar që të kem një kuptim më të mirë rreth asaj se çfarë më pret kur të diplomoj dhe se si mund t'i përdor njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë studimeve – thjesht nuk frikësohem aspak të dal nga ky universitet dhe të bëhem pjesë e fuqisë punëtore në Maqedoni apo diku jashtë".

Drilon Iseni, LLM
i diplomuar në Drejtësi
Kryetar i Asociacionit të ish-studenteve të UEJL



"Përveç njohurive profesionale që fitova në UEJL, rol të rëndësishëm në zhvillimin tim profesional ka luajtur edhe Qendra e Karrierës. Trajnimet për karrierë që i ofron kjo qendër më kanë ndihmuar shumë që të jem i suksesshëm gjatë intervistave të ndryshme për punësime dhe studimeve pasuniversitare. Qendra e Karrierës është vetëm njëra nga vlerat që e bëjnë UEJL-në lider rajonal të arsimit të lartë".



UEJL, në vazhdimësi mundohet të aplikojë një qasje interaktive, duke e vendosur studentin në qendër të vëmendjes në të gjitha aktivitetet dhe shërbimet e ofruara dhe njëkohësisht duke bërë përpjekje të vazhdueshme për zhvillimin e stafit. UEJL ka bashkëpunim të ngushtë dhe një aleancë strategjike me universitetet më me renome në lidhje me programet e trajnimit me qëllim të zhvillimit të stafit akademik dhe për të pasur qasje në mësimdhënie/mësimnxënie.

Lehtësimet gjatë studimeve në qytezën e UEJL-së

UEJL është ndërtuar sipas principit gjithçka në një vend, duke mundësuar interaksion gjithëpërfshirës midis studentëve të të gjitha disiplinave të studimit. Qyteza universitare ngërthen në vete hapësira të gjelbërta dhe objekte akomodimi, përfshirë katër amfiteatro të mëdha me kapacitet për 200 deri në 500 studentë, më shumë se 30 klasa me kapacitet prej 30 deri 60 studentë, dy qendra kompjuterike bashkëkohore me më shumë se 450 kompjuterë, librari, konvikte për banim dhe një numër të madh të fushave për rekreacion. Qyteza vazhdimisht është zgjeruar me ndërtesa të reja, duke shtuar kapacitetet ekzistuese për studim.

Pajisjet e mësimdhënies janë moderne dhe praktike, duke ofruar kushte optimale për aplikim të mësimt interaktiv. Çdo klasë është e pajisur me internet, pra lidhja me botën është e mundur me lehtësi nga çdo kënd i Universitetit.

Infrastruktura e teknologjisë informatike (TI)

Teknologjia informatike (TI), është e njohur për të thyer distancën, për t'i hequr barrierat e kohës për t'u lidhur me kontinentet dhe për t'i afruar njerëzit, në atë mënyrë që prekë elementet kryesore se si jetojmë dhe punojmë. Ky revolucion, gjithashtu është domethënës edhe për mësimdhënien dhe mësimnxënien dhe konsiderohet si element kyç për sigurimin e cilësisë në Universitet.

UEJL është një kampion i padiskutueshëm në rajon sa i përket përdorimit të TI dhe përdorimit të sistemeve të rrjetit në mësimdhënie dhe mësimnxënie, duke ju mundësuar studentëve qasje në shërbimet e Universitetit dhe informata në lidhje me studimet e tyre on-line në çdo kohë.

Të gjithë studentët pas regjistrimit kanë akauntin e tyre, i cili ju mundëson qasje në softuerët më të avancuar të Microsoft Office dhe softuerë aplikativë të tjerë më të specializuar, si dhe qasje në burimet e mësimt elektronik (Angel), portali i studentëve(e services), Internet dhe webmail. Sipas ofertës më të fundit, bazuar në një marrëveshje ekskluzive me Gmail, çdo student i UEJL-së i ofrohet 6 GB hapësirë me mundësi përdorimi 24 orë, d.m.th. edhe me mundësi kyçjeje nga shtëpia.

Përkrahje financiare

Më shumë se 100 bursa studentore dhe 120-150 studentë të angazhuar përmes programit "Punë dhe Studim".

Për shkak të barrës financiare që krijon shkollimi në familje, të gjithë studentët në UEJL mund të aplikojnë për përkrahje financiare përmes Zyrës për ndihma financiare.

Bursat paraqesin një formë të përkrahjes financiare që u ofrohet studenteve të rinj. Kjo u mundësohet atyre përmes granteve nga donatorët të jashtëm, por edhe nga vetë buxheti i UEJL-së. Çdo vit ndahen një numër i madh bursash për studentët e rinj, mbi 100, që mbulojnë 80% të detyrimit vjetor për shkollim dhe harxhime të tjera studimore. Një pjesë e bursave ndahen kryesisht në bazë meritore, kurse pjesa tjetër kryesisht sipas gjendjes financiare të studentit dhe familjes së tij. Kriteret e sakta për akordim të bursave bëhen të ditura në konkursin për pranimin e studentëve të rinj dhe në formularët për aplikim. Pjesë e pakos për përkrahje financiare ofruar studentëve nga UEJL është edhe mundësia për t'u bërë pjesë e programit "Punë & Studim", e cila u mundëson studentëve të shlyejnë obligimet financiare ndaj Universitetit, duke punuar në qytezën universitare me orar të shkurtuar. Të gjithë studentët mund të aplikojnë në programin "Punë & Studim", por përparësi kanë vetëm ata, të cilët demonstronjë qartë një nevojë për përkrahje financiare. Programi "Punë & Studim" përfshin çdo vit 120 deri 150 studentë.

Agon Latifi
Administrim Biznesi
(Absolvent, viti i III-të
me planprogram 3 vj.)



"Në UEJL më se shumti më pëlqen mjedisi, mënyra interaktive e mësimt, puna në grupe gjatë orëve të praktikës. Gjithashtu, vlen të përmendet edhe prania e profesorëve të njohur nga shtetet e huaja, si dhe vizita të ndryshme, që i bëhen universitetit tonë nga shumë personalitete të njohura akademike".



Element tjetër në pakon për përkrahje financiare, që u ofrohet studentëve të rinj, është edhe mundësia për lehtësim financiar për studentin e dytë, apo të tretë të familjes, me një lirim prej 15%, përkatësisht 25% nga detyrimi financiar për pagesën e shkollimit.

Studentët që dëshirojnë t'i shfrytëzojnë këto mundësi sugjerohen që ta vizitojnë uebfaqen e Universitetit ose të kontaktojnë drejtpërsëdrejti Zyrën për mbështetje financiare (Tel: 044 356 044), për informacione plotësuese lidhur me kushtet dhe afatet për aplikim.



Vullnet Sulejmani
Student, viti i II-të
Shkencat
Kompjuterike

"Ka shumë arsye, për të cilat më pëlqen studimi në UEJL. Kushtet janë shumë të mira. Ligjëratat bëhen në mënyrë profesionale, të shkallës së lartë, jo si më parë. Profesorët janë shumë komunikues me studentët dhe kjo na bënë të ndjehemi se jemi në qendër të vëmendjes".

Shërbime profesionale të karrierës

UEJL njihet për suksesin e të diplomuarve në tregun e punës. Një ndër arsyet është se ne kujdesemi për ju gjatë kohës, edhe pas diplomimit tuaj. Përmes Qendrës së karrierës, ne ju ndihmojmë në identifikimin, planifikimin dhe arritjen e karrierës suaj të preferuar.

Çfarë mund t'ju ofrojë Qendra e karrierës?

- Udhëzime individuale për karrierën
- Kritikë konstruktive për biografinë (CV) tuaj dhe letrën e motivimit (Cover Letter)
- Lëndë të karrierës, seminare, punëtori dhe ngjarje të ngjashme (Panaire të karrierës, prezantime të kompanive, etj.)
- Burime të karrierës (tekste universitare, DVD, informatorë, fletushka, etj.)
- Publikime në softuerin tonë on-line, Career Service Manager, të mundësive për punësime me orar të plotë, me orar të shkurtuar dhe punë praktike (internship)
- Ndihmë në paraqitjen e anëve të forta në biografinë (CV) tuaj, aplikimet për punë dhe gjatë intervistave
- Intervista simuluese dhe shumë gjëra të tjera

Qendra e karrierës ju përkrah në gjetjen e një vendi adekuat për punë ose punë praktike. Qendra ka një ekip të përkushtuar në kuptimin e mirëfilltë për tregun e punës dhe me lidhje të ngushta me punëdhënës me renome. Gjatë viteve të fundit, ekipi ka qenë shumë i suksesshëm në tërheqjen e punëdhënësve në qytetë dhe punësimin e studenteve, në pikërisht këto kompani /punëdhënës/, që përfshin Qeverinë dhe institucionet publike, Cosmofon-in, ProCredit Bank-ën, Telekomin e Maqedonisë, Stopanska Bank-ën, Librin e Artë, Alsat-M, USAID-in, UNDP-në, Gudalat-in dhe shumë punëdhënës të tjerë.





"Falë një organizimi të mirë dhe kushteve të mira për studentët me aftësi të kufizuara, më mundësohet qasje më e lehtë në të gjitha objektet dhe shërbimet e ofruara në universitet, duke përfshirë edhe aspektin financiar. Mua dhe studentëve të tjerë me aftësi të kufizuara na është dhënë përparësi në shpërndarjen e bursave dhe përfshirjen në programin " Pune & Studim". Nëse nuk do të ishin këto mundësi, vështirë se do të kisha arritur të vazhdoj studimet e mia universitare".

Jahi Bakiji,
i diplomuar në Drejtësi
Sekretariati gjeneral – Qeveria e
Maqedonisë



eService

eService është portali i UEJL-së, i cili u mundëson studentëve qasje tek një gamë e gjerë shërbimesh, 24 orë në ditë përmes internetit, duke përfshirë këtu shërbime dhe informata p.sh. në lidhje me gjendjen financiare, pasqyrën e notave të arritura (transkripta), përpilimin e orarit, paraqitjen dhe pasqyrën e provimeve, etj. Qëllimi i portalit, eService, është që të krijohet një shoqëri virtuale-një vend për të studiuar, punuar dhe për t'u argëtuar!

Qendra kompjuterike

Universiteti ofron kushte shumë të mira kompjuterike për të përkrahur studimet e juaja. Përmes dy qendrave kompjuterike ne qytetëzën universitare, UEJL u mundëson studentëve qasje në mbi 450 kompjuterë - të gjithë të pajisur me programet më të reja dhe më të avancuara, duke përfshirë këtu edhe qasje në internet përmes një lidhje të shpejtë. Qendrat kompjuterike janë të hapura gjatë gjithë javës, prej orës 08.00 - 22.00, kurse të shtunën prej orës 08.00-17.00.

Biblioteka

Biblioteka e Universitet 'Max Van Der Stoel', e vendosur në mënyrë të përshtatshme në qytetë, ofron qasje në një gamë të gjerë materialesh në mbështetje të mësimin, mësimdhënies, dhe kërkimit shkencor në UEJL në gjuhën shqipe, maqedonase, angleze, frënge, gjermane, italiane dhe gjuhë të tjera. Koleksioni i bibliotekës përfshinë më shumë se 20.000 tituj dhe më shumë se 30.000 libra në total, përveç një numri të madh revistash, raportesh ndërkombëtare, CD-ROMs, gazetash ndërkombëtare dhe lokale, si dhe periodikësh të tjerë.

Biblioteka është e hapur gjatë të gjitha ditëve të javës nga 08.00-23.00 dhe të Shtunave nga 10.00-14.00. Gjatë tërë kohës studentët kanë qasje jo vetëm në koleksionin e bibliotekës, por edhe në kompjuterët, internetin dhe sallat e leximit që përputhen me kërkesat dhe nevojat e çdo studenti.

Mbështetje për studentët me aftësi të kufizuara

UEJL mirëpret çdo aplikim për studim nga personat me aftësi të kufizuara. Studentëve me aftësi të kufizuara u jepet përparësi gjatë shpërndarjes së bursave, kurse qytetza universitare që nga fillimi është ndërtuar me qëllim që t'u mundësojë personave me aftësi të kufizuara lëvizje të lehtë dhe qasje në të gjitha objektet e nevojshme për një eksperiencë sa më të mirë studentore. Universiteti është i pajisur me rampa, WC të përshtatshme dhe me ashensorë në të gjitha ndërtesat me më shumë se një kat. Në rast se jeni me aftësi të kufizuara dhe keni nevojë për kujdes të veçantë, jemi shumë të interesuar të bisedojmë me ju në lidhje me nevojat apo kufizimet tuaja. Prandaj, për aplikim për studim në UEJL ose për informacione plotësuese në lidhje me mbështetjen që ne mund t'ua ofrojmë, ju lutemi kontaktoni drejtorin e Zyrës për shërbime studentore, në tel. +389 44 356 045.



Amit Skenderi,
student, viti i III-të
Shkencat Kompjuterike

"Mua, në fakt, më pëlqejnë shumë gjera, por nëse duhet të veçoj diçka, do të ishin qendrat kompjuterike, apo me fjalë të tjera, infrastruktura e teknologjisë informative në qytetë. Kjo është edhe arsyeja kryesore pse unë që në fillim u përcaktova të studioj në UEJL. Për mua është shumë me rendësi që studimet të jenë sa praktike aq edhe teorike, prandaj për të studiuar një drejtim, siç është ky i shkencave kompjuterike është shumë me rendësi që t'i kesh jo vetëm pajisjet e nevojshme, siç janë kompjuterët dhe softuerët e ndryshëm, por edhe profesorët të jenë të aftë dhe në gjendje t'i ndjekin risitë në këtë lëmi që ndryshon çdo ditë"



Akomodimi i studentëve (Konviktet)

Një veçori unike e UEJL është mundësia e akomodimit në qytezë, me 7 konvikte me kapacitet strehimi për 450 studentë. Konviktet janë të pajisur me kompjuterë me qasje në rrjetin e Universitetit (internet) dhe janë të dizajnuar për të përmbushur standardet e konvikteve moderne, duke u ofruar banuesve mundësinë e një vendi të përshtatshëm për studime.

Të gjithë të interesuarit për vendosje në qytezë duhet që, për shkak të kërkesës së madhe, të aplikojnë në afat sa më të shkurtër. Për informata plotësuese, ju lutemi kontaktoni Zyrën për informim në tel. + 389 44 356 188. Prioritet kanë studentët që vijnë nga qytetet që janë larg Tetovës.

Gjatë viteve të fundit edhe sektori privat i akomodimit të studentëve ka shënuar rritje të konsiderueshme, kështu që akomodimi privat pranë qytezës së Universitetit mund të sigurohet lehtë dhe me çmime shumë të volitshme.



Nertila Dika,
studente, viti i
III-të, Fakulteti i
Gjuhëve, Kulturave
dhe Komunikimit

Objektet dhe aktivitetet rekreative

Shumëllojshmëria është fjala kryesore në përshkrimin e mundësive të shumta për zbavitje që ofron qyteza e Universitetit. Në frymën e pasurimit të përvojës së studimeve, UEJL bën përpjekje të përhershme për të siguruar përmbajtje cilësore rekreative me qëllim të përmirësimit të jetës shpirtërore, mentale dhe shoqërore të studentëve, profesorëve dhe punëtorëve të administratës. Për këtë qëllim, qyteza pasurohet, në mënyrë të vazhdueshme, me vende të rehatshme për çlodhje, për mësim dhe për shoqërim të studentëve, si dhe objekte të nevojshme për aktivitete sportive si futboll, basketboll, hendboll, volejball, pingpong etj.

“Më pëlqejnë shumë gjëra, por më së shumti më pëlqen përkrahja financiare, bursat dhe programi “Punë & Studim”. Shumë të rinj kanë dëshirë të studiojnë, por nuk kanë mundësi për shkak të gjendjes financiare, ashtu siç ka qenë edhe rasti im, por falë mundësisë për bursë që e ofronte Universiteti, unë arrita të bëhem studente, e me këtë edhe fillova t’i realizoj ëndërrat e mia”

Unioni i Studentëve

Unioni i Studentëve (US), është një organizatë e pavarur brenda UEJL, e udhëhequr nga vetë studentët. Qëllimi kryesor i US është që të përfaqësojë dhe të mbrojë interesat e studentëve, por edhe të ndikojë pozitivisht dhe në mënyrë konstruktive në përvojën studentore, duke organizuar aktivitete të ndryshme akademike, shoqërore dhe zbavitëse. US përfaqësohet në organet vendimmarrëse të Universitetit dhe mban disa klube, ku ju mund ta pasuroni përvojën tuaj akademike dhe shoqërore në UEJL.



Pranimi i studentëve - si të aplikoj?

UEJL ndjek një politikë të hapur pranimesh, që u nënshtrohet disa kufizimeve. Pranimi i hapur do të thotë se Universiteti zotohet të pranojë cilindo që është i kualifikuar për të marrë pjesë në programet e tij akademike. Prandaj, për t'u konsideruar për studim në UEJL, kandidatët duhet t'u përgjigjen kushteve për pranimin e caktuar nga Universiteti, por njëkohësisht edhe kërkesave të caktuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës së RM, për studim universitar.

Formularët për aplikim mund të shkarkohen nga uebfaqja e Universitetit dhe përmes Zyrës për informim të studentëve në Universitet.

Vëni re: Pranimi i studentëve bëhet në bazë të konkursit të aprovuar nga Senati i Universitetit, i cili shpallet çdo vit, disa muaj para afatit të fundit për aplikim në uebfaqen e Universitetit dhe në një pjesë të madhe të shtypit të shkruar ditor. Konkursi, përveç numrit të studenteve që do të pranohen dhe çmimit për studim, përmban edhe informata të hollësishme në lidhje me afatet dhe kushtet e parapara për pranim në programet studimore të ofruara nga Universiteti për vitin përkatës.

Biljana Matlijovska,
viti i I-rë
Fakulteti i Gjuhëve,
Kulturave dhe
Komunikimit - Anglisht



"Të jesh pjesë e UEJL-së mjafton vetëm të kesh dëshirë dhe më vonë vijnë të gjitha, si bursat e ndryshme, mundësitë për punë dhe studime dhe shumë e shumë privilegje të tjera. Ne studentët kemi mundësi, që kohën e lirë ta shfrytëzojmë duke bërë punë vullnetare në Qendrën e karrierës dhe Qendrën për zhvillimin e biznesit".

Studime të rregullta / Studime me korrespondencë

Kandidatët për studime në UEJL mund, varësisht nga programi studimor, të aplikojnë për studime të rregullta ose për studime me korrespondencë. Për të studiuar vlejnjë të njëjtat kushte për pranim, duke përfshirë këtu edhe të njëjtat çmime.

Studentët e rregullt dhe ata me korrespondencë mund të ndryshojnë statusin e tyre duke bërë një kërkesë tek dekani i fakultetit përkatës, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar. Për më shumë informacione në lidhje me studimet me korrespondencë, ju lutemi kontaktoni Zyrën për studime me korrespondencë, në tel: +389 44 356 033.

Studentët ndërkombëtarë

Kushtet për pranimin e studenteve që nuk janë shtetas të RM-së, dallojnë varësisht nga shteti nga i cili vijnë, prandaj për informata më të sakta për kushtet e pranimit, ju lutemi referohuni konkursit të shpallur në uebfaqen e universitetit, ose në +389 44 356 188.

Transferimi në UEJL nga një universitet tjetër

E drejta për t'u transferuar në UEJL nga ndonjë universitet tjetër do t'i mundësohet cilitdo student që e ka kompletuar së paku një vit studimi në universitetin përkatës dhe me një notë mesatare mbi 7.00 (ekuivalent me procedurat vlerësuese të UEJL). Maksimumi i kredive (ECTS), që mund të transferohen kundrejt një titulli të ciklit të parë të studimeve (deridiplomike), është 90 kredi.

Vëni re: Afati për transferim ndryshon nga afatet për pranim të studentëve të rinj, prandaj për informacione më të hollësishme, ju lutemi kontaktoni Zyrën për informim.

Pagesa për studimet

Sipas Ligjit të Republikës së Maqedonisë Universiteti i EJL është klasifikuar si institucion "privat-publik jofitimprurës" i edukimit të lartë, për t'u dalluar nga institucionet 'publike', të cilat marrin financim direkt nga shteti.

Si rezultat, pagesat për studime në UEJL janë më të larta se ato të universiteteve publike për studentët që nuk arrijnë ta marrin një vend të financuar nga shteti. Për informata plotësuese mbi pagesat për studimet, ju lutemi kontaktoni Zyrën për informim ose shihni konkursin për pranimin e studenteve të rinj në uebfaqen e Universitetit.

Mimoza Nagavci,
Administratë Publike
viti i IV



"Më së shumti më pëlqen infrastruktura, të jep më shumë motivim për aktivitete studimore, të jep më shumë hapësirë për të menduar më lirshëm. Po ashtu, do të veçoja rregullsinë që zotëron në qytezën universitare, ambientin e pastër, klasat dhe ambientin shoqëror. Këtu më ndryshe se në universitet tjera është edhe sistemi i notimit, vlerësimi hap pas hapi. Kjo më bënë që të jem më aktive dhe të kem më tepër motiv për të mësuar".



UNIVERSITETI I EJL
ЈИЕ УНИВЕРЗИТЕТ
SEE UNIVERSITY



KOMPLEKSI • КОМПЛЕКС • CAMPUS

- | | | | |
|----------|--|----------|---|
| 101 | ➤ Sigurimi
Обезбедување
Gate Security | 600 | ➤ Sallë shumëqëllimesh
Повеќенаменска сала
Multipurpose Hall |
| 201-207 | ➤ Vonesë studentësh
Студентски домови
Student Houses | 700, 701 | ➤ Qendra kompjuterike
Компјутерски центар
Computer Center |
| 203 | ➤ Pallati ndërkombëtar
Интернационален дом
International House | 702 | ➤ Biblioteka
Библиотека
Library |
| 301-305 | ➤ Administrata
Администрација
Administration | 801-815 | ➤ Salla mësimi
Училиници
Classrooms |
| 400 | ➤ Sallë leximi
Читална
Reading-Studying | 900 | ➤ Ndërtesa për mirëmbajtje
Зграда за одржување
Maintenance Building |
| 500, 501 | ➤ Amfiteatri
Амфитеатар
Lecture Hall | | |

FAKULTETET

Administrimi i Biznesit

Titulli i ofruar:

Bachelor of Arts (BA)

Fakulteti / Departamenti:

Fakulteti i Administrimit të Biznesit

Kohëzgjatja e studimeve:

3 vjet (6 semestra) - 180 kredi

Gjuha e studimeve:

Shqip / Maqedonisht

Kushtet për aplikim:

shihni konkursin në:
www.seeu.edu.mk

Kontaktet:

tel: +389 44 356 056

fax: +389 44 356 001

Përmbajtja e programit dhe struktura

Struktura e programit përfshin studime, të cilat janë dinamike, të harmonizuara dhe interaktive. Lëndët në këtë program, përmbajnë njohuri teorike, ngushtë të lidhura në aplikimet praktike, në përditshmërinë e biznesit. Lëndët e studimit janë dizajnuar për t'i orientuar studentët në profesionin e tyre dhe më vonë të specializohen në këtë fushë, por në të njëjtën kohë edhe t'i përgatisë ata për një cikël të punës praktike (internship). Kjo përvojë do t'u japë mundësi që të reflektojnë mbi atë që e kanë mësuar gjatë studimit dhe të zgjerojnë rrjetin e tyre shoqëror përpara diplomimit.

Rezultatet nga programi mësimor

Qëllimi i programit të Administrimit të Biznesit është që t'i nxjerrë të diplomuar, ata të cilët do të ndihmojnë, apo do ta çojnë përpara zhvillimin e organizatave gjatë sfidave të tyre në të ardhmen. Studentët janë ata që pritet të posedojnë dhe demonstrojnë shumëllojshmëri të shkathtësive, njohurive dhe përgjegjësive pas përfundimit me sukses të këtyre studimeve.

Studentët pritet që të fitojnë njohuri të forta dhe të integruara në fusha thelbësore të biznesit si: të ekonomiksit, kontabilitetit, financave, marketingut, teknologjisë së informimit dhe të menaxhimit, në një nivel, që në mënyrë efektive të kontribuojnë dhe menaxhojnë me projekte në ndonjërin nga këto fusha. Pas diplomimit, gjithashtu do të kenë të zhvilluara aftësitë ndërpersonale dhe ato për komunikim, ku si shtesë do të fitojnë edhe aftësi të shkëlqyera në përdorimin e teknologjisë informative. Këto janë njohuri thelbësore, të cilat nevojiten për të pasur sukses në mjedisin konkurrues të biznesit aktual.

Përfundimisht, nga studentet pritet që të demonstrojnë aftësi për të aplikuar konceptet e biznesit në projekte reale dhe të plotësojnë me efektivitet dhe eficiency pozitat e ndryshme në mjedisin lokal dhe global.


Metodologjia e mësimdhënies dhe mësimnxënies

Programi i biznesit përdor lloje të ndryshme të stilit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Koncepti i njohurive përmbushet nga ligjëratat, ushtrimet dhe punimet seminarike /projektet. Studentët, gjithashtu, do të punojnë në grupe të vogla punuese, ku do të ndeshen me raste studimi, lojë biznesi, simulime, zgjidhje problemesh, shkrimin e raporteve të biznesit, prezantime dhe luajtje të roleve. Një detyrë e këtij lloji, do t'u ndihmojë studentëve që të zhvillojnë atributet që ju nevojiten gjatë menaxhimit të bizneseve. Këtotribute përfshijnë të menduarit logjik, komunikimin e qartë, aftësitë për të analizuar problemet dhe punën në ekiye. Rëndësia e teknologjisë informative është e pranishme së bashku me përdorimin e saj, si një pjesë përbërëse e qasjes së mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Mundësitë për karrierë

Fakulteti i Administrimit të Biznesit ka lidhje të ngushta bashkëpunimi me shumë organizata të suksesshme në vend, në rajon dhe më gjerë. Ky fakt, u mundëson të diplomuarve që të jenë një hap më përpara në tregun e punës, duke iu dhënë atyre më shumë mundësi për të gjetur punë dhe për të zhvilluar karrierë të bujshme në fushën e tyre të zgjedhur.

Të diplomuarit në Administrimin e Biznesit, do të pajisen me diplomë të njohur në perspektivë të gjerë ndërkombëtare/evropiane dhe do të kenë mundësinë që të punësohen në organizata të sektorit publik dhe privat në kontekst të funksioneve të biznesit si p.sh. menaxher të operacioneve, këshilltarë biznesi, administratorë, analistë financiarë, kontabilistë, menaxherë të resurseve humane, menaxherë për marrëdhënie me publikun, menaxherë të marketingut, hulumtues të tregut dhe shumë pozita tjera sfiduese. Diploma, gjithashtu ofron bazat për të vazhduar studimet pasuniversitare në shumë universitete të akredituara në të gjithë botën.





Përmbajtja e programit dhe struktura

Programi trevjeçar “Bachelor of Arts” i ofruar nga Fakulteti i Drejtësisë përbëhet nga module, të cilat përmbajnë bazat e njohurisë legale, e cila do të lejojë qasje në shumë profesione si të juridikut ashtu edhe të tjera.

Rezultatet nga programi mësimor

Në fund të programit, studentët pritet që të fitojnë dituri të forta dhe kuptim për: Konceptet, parimet dhe rregullat thelbësore të juridikut, duke përfshirë njohuri të thella në disa fusha të juridikut si: E drejta komerciale, civile, kriminale, administrative dhe krahasuese.

Tiparet themelore të së Drejtës së Unionit Evropian, Marrëveshjet evropiane të të drejtave të njeriut dhe të tjera marrëveshje në të Drejtën ndërkombëtare publike dhe private, Gjuhë Angleze (obligative), por edhe Gjuhën Frënge dhe Gjermane (zgjedhore), deri në një nivel të arsyeshëm.

Relacionet midis drejtësisë dhe konteksteve historike, linguistike, socio-ekonomike dhe politike me të cilat ajo operon.

Një varg të perspektivave teorike, krahasuese dhe kritike, që mund të aplikohen në studimet e juridikut.

Metodologjia e mësimdhënies dhe mësimnxënies

- Ligjërata tradicionale dhe interaktive (sokratike)
- Orë për shqyrtimin e problemeve juridike
- Seminare
- Hulumtim të pavarur për vlerësimet e lëndës
- Përgjigje nga vlerësimet e lëndës.

Mundësitë për karrierë

Diploma që ofrohet nga Fakulteti i Drejtësisë është e njohur nga Organizata profesioniste e avokatëve dhe noterëve. Titulli profesionist avokat apo noter, kërkon regjistrim formal në këtë organizatë. Kërkesat për regjistrim janë të rregulluara me ligj. Diploma në Drejtësi ju mundëson qasje në shërbimet publike, veçanërisht në gjykatë; studentët, të cilët dëshirojnë të merren me punë shkencore, Fakulteti i Drejtësisë, iu mundëson vazhdimin e studimeve në MA dhe PhD.

Drejtësia

Titulli i ofruar:
Bachelor of Arts (BA)

Fakulteti/ Departamenti:
Fakulteti i Drejtësisë

Kohëzgjatja e studimeve:
3 vite (6 semestra)- 180 kredi

Gjuha e studimeve:
Shqip/Maqedonisht

Kushtet për aplikim:
shihni konkursin në:
www.seeu.edu.mk

Kontaktet:
tel: +389 44 356 133
fax: +389 44 356 001



Shkencat Kompjuterike

Titulli i ofruar:
Bacherlor of Science (BSc)

Fakulteti / Departamenti:
Fakulteti i Shkencave dhe
Teknologjive Bashkëkohore /
Shkencat Kompjuterike

Kohëzgjatja e studimeve:
3 vite (6 semestra)- 180 kredi

Gjuha e studimeve:
Shqip / maqedonisht

Kushtet për aplikim:
shihni konkursin në:
www.seeu.edu.mk

Kontaktet:
tel: +389 44 356 176
fax: +389 44 356 001

Rezultatet nga programi mësimor

- Njohuri teorike dhe praktike për sistemet kompjuterike bashkëkohore dhe teknologjitë e informacionit, si dhe shkathtësi për shfrytëzimin e tyre në zgjidhjen e problemeve të ndryshme.
- Njohuri mbi algoritme dhe metoda të ndryshme, si dhe përdorimin e tyre në zgjidhjen e problemeve të ndryshme.
- Menaxhim me shënime digjitale, organizim dhe përpunim të tyre
- Aftësi për zhvillimin dhe implementimin e zgjidhjeve të ndryshme softuerike, qoftë të natyrës desktop apo për Internet rrethinë.
- Aftësi në analizimin, projektimin dhe implementimin e rrjetave të ndryshme kompjuterike.
- Zhvillim të aftësive për punë kërkimore shkencore në lëmin përkatës.
- Aftësi për të shfrytëzuar literaturë dhe burime të ndryshme të të dhënave.
- Aftësi për punë praktike individuale dhe grupore.

Metodologjia e mësimdhënies dhe mësimnxënies

Procesi studimor zhvillohet nëpër klasa të reja dhe në grupe të vogla, për të lejuar një interaktivitet më intensiv në klasë dhe duke ju mundësuar studentëve të jenë pjesëmarrës aktiv në zhvillimin e procesit mësimor-shkencor. I gjithë procesi mbështetet nga një infrastrukturë më bashkëkohore TI, duke përfshirë klasa të pajisura me kompjuterë më bashkëkohorë dhe laboratorë të specializuar për lëndë profesionale. Studentëve iu ofrohen kushte optimale për mësim, hulumtim, eksperimentim, punë në grupe, punë individuale, punime seminarike, etj. Në shërbim të studentëve është edhe biblioteka me literaturë adekuate për lëndët bashkëkohore nga lëmi i shkencave kompjuterike.

Vlerësimi i studentëve bëhet gjatë gjithë semestrit të studimeve, duke filluar që nga rregullsia e tyre në orë, aktiviteti i treguar gjatë orëve, punimet e ndryshme seminarike, ushtrimet laboratorike dhe nga dy testime, të cilët kanë rëndësinë kryesore në sajimin e notës përfundimtare. E gjithë kjo metodë bëhet me qëllim që të arrihet një vlerësim korrekt i aftësive akademike dhe studimore të studentëve.

Mundësitë për karrierë

Lëmi i shkencave kompjuterike është në zhvillim të vazhdueshëm dhe përplot me risi. Kjo, është lëmi e ardhmërisë dhe me perspektivë premtuese. Ka zbatim universal gati se në të gjitha sferat e jetës. Kompanitë e telekomunikacionit, kompanitë e ndryshme për zhvillim softueri, qoftë vendore apo të huaja, si dhe sektori bankar janë treguar si punëdhënësit më të mëdhenj për të diplomuarit në shkencat kompjuterike. Megjithatë, ekziston një perspektivë e qartë për punësim edhe në të gjitha sferat tjera të sektorit shtetëror dhe të atij privat. Në këtë drejtim, në shërbim është edhe Qendra e karrierës në UEJL, e cila mban lidhjet me sektorin e biznesit dhe ofron trajnime për sukses në karrierën profesionale.





Rezultatet nga programi mësimor

- Njohuri teorike të kohës nga teknologjitë e informacionit dhe komunikimit, si dhe shkathtësi të implementimit praktik në jetën reale të të njëjtave dhe përvoja profesionale.
- Shkathtësi në projektim, dizajnim dhe inovacion të pajisjeve dhe teknologjive bashkëkohore të informacionit dhe komunikimit.
- Aftësi për riparim dhe mirëmbajtje të pajisjeve teknologjike nga lëmi përkatës.
- Shkathtësi për zhvillim dhe përmirësim të performansave të pajisjeve të informacionit dhe komunikimit.
- Zhvillim të aftësive për punë kërkimore shkencore nga lëmi përkatës.
- Aftësi për të shfrytëzuar literaturë dhe burime të ndryshme të të dhënave.
- Aftësi për punë praktike individuale dhe grupore.

Metodologjia e mësimdhënies dhe mësimnxënies

Procesi studimor zhvillohet nëpër klasa të reja dhe të rregulluara për mësim interaktiv, ku theks të veçantë i jepet aktivizimit të studentëve gjatë orëve praktike. Ligjëratat mbahen në klasë të pajisura me kompjuterë dhe në laboratorë të specializuar për lëndë profesionale. Studentëve iu ofrohen kushte optimale për mësim, hulumtim, eksperimentim, punë në grupe, punë individuale, punime seminarike, etj. Në shërbim të studentëve është edhe biblioteka me literaturë adekuate për lëndë bashkëkohore nga lëmi i informacionit dhe komunikimit.

Vlerësimi i studentëve bëhet gjatë gjithë semestrit të studimeve, duke filluar që nga rregullsia e tyre në orë, aktiviteti i treguar gjatë orëve, punimet e ndryshme seminarike, ushtrimet laboratorike dhe nga dy testime, që kanë rëndësinë kryesore në sajimin e notës përfundimtare. E gjithë kjo metodë bëhet me qëllim që të arrihet një vlerësim korrekt i aftësive akademike dhe studimore të studentëve.

Mundësitë për karrierë

Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit paraqesin lëminë që është në zhvillim të vazhdueshëm dhe përplot me risi. Kjo, është lëmi e ardhmërisë dhe perspektivë, premtuese. Ka zbatim universal gati se në të gjitha sferat e jetës. Të diplomuarit në këtë drejtim, përveç mundësisë së shfrytëzimit të teknologjive të reja do të jenë të aftësuar edhe në aspektin inxhinierik, për projektim, dizajnim dhe konstruktiv të pajisjeve moderne bashkëkohore dhe gjithashtu edhe për riparim dhe mirëmbajtje të të gjitha pajisjeve nga lëmi në fjalë. Mund të punësohen në të gjitha sferat e sektorit shtetëror dhe të atij privat. Në këtë drejtim, në shërbim është edhe Qendra e karrierës në UEJL, e cila mban lidhjet me sektorin e biznesit dhe ofron trajnime për sukses në karrierën profesionale.

Inxhinieria Kompjuterike

Titulli i ofruar:
Bacherlor of Science (BSc)

Fakulteti / Departamenti:
Fakulteti i Shkencave dhe
Teknologjive Bashkëkohore /
Teknologjitë e Informimit dhe
Komunikimit

Kohëzgjatja e studimeve:
3 vite (6 semestra) - 180 kredi

Gjuha e studimeve:
Shqip/maqedonisht

Kushtet për aplikim:
shihni konkursin në:
www.seeu.edu.mk

Kontaktet:
tel: +389 44 356 176
fax: +389 44 356 001



Informatika e Biznesit

Titulli i ofruar:
Bacherlor of Sciences (BSc)

Fakulteti / Departamenti:
Fakulteti i Shkencave dhe
Teknologjive Bashkëkohore

Kohëzgjatja e studimeve:
3 vite (6 semestra) - 180 kredi

Gjuha e studimeve:
Anglisht

Kushtet për aplikim:
shihni konkursin në:
www.seeu.edu.mk

Kontaktet:
tel: +389 44 356 176
fax: +389 44 356 001

Përmbajtja e programit dhe struktura

Informatika e Biznesit është program studimor që shërben si urë lidhëse midis biznesit dhe teknologjive të informimit, duke krijuar kështu një impuls në biznes me përdorimin e teknologjive më të reja në sferën e TI-së. Studentët e diplomuar në këtë drejtim do të jenë bartës të inovacioneve dhe do të vendosen në vende kyçe kudo në organizata.

Tregu për aftësi të këtilla kalon në një ekspansion të shpejtë e posaçërisht me procesin e globalizimit dhe liberalizimit të tregut evropian për punë.

Rezultatet nga programi mësimor

Ekspertët e informatikës dhe të biznesit janë interpretues midis TI dhe stafit të biznesit. Ata i kuptojnë mirë nevojat e biznesit dhe dinë t'i interpretojnë këto nevoja në gjuhën e TI-së. Ata, gjithashtu dinë të krijojnë avantazh konkurrues, duke implementuar sisteme informative që i përmirëson proceset e biznesit dhe bën automatizimin e disa proceseve.

Kjo, kërkon jo vetëm njohuri në biznes dhe teknologji të informimit, por edhe aftësi komunikuese që kjo njohuri mund të shprehet në mënyrë që të kuptohet nga të dy palët. Programi i informatikës së biznesit i përfshin këto aspekte dhe ju bën ekspertë në biznes në TI dhe komunikim!

Metodologjia e mësimdhënës dhe mësimnxënies

Programi i Informatikës së Biznesit është bazuar në metoda moderne të mësimin. Programi ka komponentët interaktive dhe praktike. Mësimi i koncepteve teorike do të jetë në mënyrë interaktive, kurse pjesa praktike do të ketë elemente nga bota reale (projekte të ndryshme në Universitet, projekte reale në kompani, si dhe raste studimore nga bota reale). Programi ka edhe laboratorë, të cilët janë të pajisur me harduerin dhe softuerin e nevojshëm për të punuar me teknologjitë e reja në praktikë.

Mundësitë për karrierë

Pas diplomimit, studentët do të kenë mundësi të vazhdojnë studimet apo të punojnë në sfera si:

- Strategjitë e TI
- TI dhe konsulentë biznesi
- Analizë dhe dizajn të sistemeve të informimit
- Analizë dhe dizajn të ueb aplikacioneve
- Menaxhim të të dhënave
- Dizajn, optimizim dhe automatizim të proceseve në biznes
- Sigurim të sistemeve të informimit





Përmbajtja e programit dhe struktura

Ky program është një ndër programet e para mësimore, nëse jo edhe i vetmi në vend, i dedikuar për shkollimin e gjeneratave të nivelit të lartë të administrimit publik.

Programi studimor (Bachelor of Arts), i Fakultetit të Administrimit Publik dhe Shkencave Politike, drejtimi i përgjithshëm Administrimi Publik, ju ofron studentëve mundësi për arritjen e aftësive të tyre komunikuese dhe hulumtuuese, si dhe të fitojnë eksperiencë në menaxhim, analizë të politikave, ekonomi dhe metoda kuantitative. Të diplomuarit janë të përgatitur për të dhënë kontributin e tyre në hartimin e politikave, menaxhimin e burimeve njerëzore në organizata publike, private dhe jofitimprurëse.

Rezultatet nga programi mësimor

Pas kompletimit të programit studimor, studentët duhet të tregojnë shkathtësi dhe aftësi në:

- Ndryshimet ekonomike, politike, sociale dhe teknologjike, që janë duke e transformuar mënyrën se si ne jetojmë dhe punojmë.
- Të përmirësojë aftësitë e komunikimit dhe hulumtimit, si dhe të ofrojë eksperiencë në menaxhim, analizë të politikave, ekonomi dhe metoda kuantitative.
- Të krijojë kuadro profesionalë dhe kompetentë për të qenë pjesë e proceseve integruese rajonale dhe ndërkombëtare (Bashkimin Evropian, NATO).
- Të krijojë një gjeneratë të re nëpunësish publikë (administratorë, menaxherë), të nivelit të lartë që do t'u përgjigjen sfidave të shoqërisë bashkëkohore.
- Të aftësojë studentët për të analizuar studime të ndryshme nga fusha e politikës aplikative, ekonomisë, kulturës, si dhe të merret me punë teorike dhe praktike që krijojnë vlera të reja dhe duke nxitur mendimin e lirë.
- Të krijojë kuadro të aftë për punë në kushte të demokracisë liberale, ekonomisë së tregut dhe kuadro të aftë, të cilët do të marrin pjesë në ndarjen ndërkombëtare të punës.
- Të mundësojë zhvillimin e aftësive personale për komunikim, hulumtim dhe aftësi të tjera të rëndësishme për punësim në administratën publike dhe në sferat tjera.

Metodologjia e mësimdhënies dhe mësimnxënies

Metodat themelore të mësimdhënies dhe studimeve të aplikuara në këtë program janë ligjëratat (tradicionale dhe interaktive, së bashku), seminarët, kërkimi i pavarur për detyrat e programit dhe praktika në nivel lokal dhe qendror (në Parlament dhe Qeveri), në semestrin final. Ndërsa, vlerësimi i studentit, do të bazohet në kriteret si:

- prania në ligjëratat
- aktiviteti;
- detyrat e shtëpisë (esetë);
- punimet seminarike;
- kolokviumi;
- provimi final

Studenti, një vlerësim final e fiton nëpërmjet plotësisht me sukses të komponentëve të lartpërmendur, si dhe nëpërmjet realizimit të punës praktike (internship), në institucionet e administratës shtetërore, publike dhe sektorit jofitimprurës dhe punimit të tezës dhe mbrojtjes publike pas përfundimit të punës praktike.

Mundësitë për karrierë

Me njohuritë e fituara profesionale dhe shkencore, pas përfundimit të programit studimor, studentët janë të përgatitur të punësohen në institucionet e specializuara, në lëmi të ndryshme të administratës shtetërore, publike, organizatat jofitimprurëse dhe në sektorin privat.

Studentët e diplomuar në këtë program studimor do të kenë mundësi t'i vazhdojnë studimet e ciklit të dytë (studimet e magjistraturës), për t'u kompletuar më tepër me njohuri dhe shkathtësi, si dhe për të pasur mundësi që të merren me punë kërkimore shkencore.

Administrimi Publik

Titulli i ofruar:
"Bachelor of Arts (BA)"

Fakulteti / Departamenti:
Fakulteti i Administratës
Publike dhe Shkencave
Politike

Kohëzgjatja e studimeve:
3 vite (6 semestra) - 180 kredi

Gjuha e studimeve:
Shqip / maqedonisht

Kushtet për aplikim:
shihni konkursin në:
www.seeu.edu.mk

Kontaktet:
tel: +389 44 356 131
fax: +389 44 356 001



Shkencat Politike

Titulli i ofruar:
“Bachelor of Arts (BA)”

Fakulteti / Departamenti:
Fakulteti i Administratës
Publike dhe Shkencave
Politike

Kohëzgjatja e studimeve:
3 vite (6 semestra) - 180 kredi

Gjuha e studimeve:
Shqip / maqedonisht

Kushtet për aplikim:
shihni konkursin në:
www.seeu.edu.mk

Kontaktet:
tel: +389 44 356 131
fax: +389 44 356 001

Përmbajtja e programit dhe struktura

Drejtimi i Shkencave Politike ka të bëjë me studimet për qeverinë, politikat publike dhe proceset, sistemet dhe sjelljet politike. Nënfishat e shkencave politike ngërthejnë në vete teori politike, filozofi politike, ideologji politike, ekonomi politike, studime dhe analiza politike, politika krahasuese, relacione ndërkombëtare dhe një mori lidhjesh të tjera me këtë fushë. Shkencëtarët politikë përdorin perspektiva humane e shkencore, si dhe mjete e variacione të qasjeve metodike që të kontrollojnë procesin, sistemin dhe dinamikat politike të të gjitha shteteve dhe rajoneve të botës.

Rezultatet nga programi mësimor

Si rezultat i kompletimit të këtij programi, studentët duhet të jenë në gjendje të:

- Dallojnë një variacion të nëndisiplinave, tema të rëndësishme dhe teknika analitike në politikat shkencore.
- Të kategorizojnë bashkëveprimet midis individëve, shtetit dhe institucioneve tjera të qeverisë, punët publike dhe politikën publike.
- Parashikojnë kulturën humane dhe variacionet politike brenda vendit dhe komunitetit global.
- Njohin natyrën dhe burimin e fuqisë dhe autoritetit.
- Vlerësojnë burimet e konflikteve sociale dhe atë se si mund të vendosen në kuptim politik.
- Të vendosin ngjarje bashkëkohore në institucione të gjëra, politike dhe kontekste sociale.
- Të krahasojnë sistemin vendas të qeverisë me të shteteve të tjera.
- Të përshkruajnë natyrën e ndryshimit në komunitetin politik global dhe karakterin kompleks të proceseve, siç është globalizimi.
- Të kenë mendime kritike dhe analitike, rezonim të logjikshëm dhe të komunikojnë në mënyrë efektive për politikën.
- Të studiojnë, mësojnë, të bëjnë kërkime (hulumtime) dhe të komunikojnë në mënyrë efektive në mjedisin on-line.
- Të diskutojnë trendet dhe çështjet e rëndësishme të debateve brenda disiplinave të shkencave politike.
- Të planifikojnë, administrojnë, interpretojnë dhe komunikojnë rezultatet e kërkesave origjinale, duke përdorur metoda bazike të kërkimit.

Metodologjia e mësimdhënies dhe mësimnxënies

Gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, studentët, do të mund të aplikojnë njohuritë e fituara për plotësimin e nevojave të popullatës në lidhje me dukuritë politike, analizojnë çështjet komplekse në lëmin e shkencave politike, duke i përdorur të tria gjuhët mësimore (shqip, maqedonisht, anglisht). T’i kuptojnë dhe përcaktojnë problemet dhe çështjet politike sipas rëndësisë së tyre. Ligjëratat interaktive, seminarët e ndryshme të udhëhequra nga tutorë, puna kërkimore e pavarur, realizimi i punës praktike në institucionet e administratës shtetërore/publike në nivelin qendror dhe lokal, si dhe në sektorin jofitimprurës, do të aftësojnë studentët të klasifikojnë problemet politike dhe t’i zgjidhin ato.

Vlerësimi realizohet, duke marrë parasysh këto komponentë: praninë në ligjërata, aktiviteti, detyrat e shtëpisë (esetë), punimet seminarike, kolokviumi dhe provimi final. Studenti, vlerësimin final e fiton nëpërmjet plotësimit me sukses të komponentëve të lartpërmendur dhe nëpërmjet realizimit të punës praktike (internship), në institucionet e administratës shtetërore, publike dhe në sektorin jofitimprurës dhe punimit të tezës dhe mbrojtjes publike pas përfundimit të punës praktike.

Mundësitë për karrierë

Studentët e Shkencave Politike përfitojnë aftësi analitike, kompetenca administrative dhe aftësi komunikuese që do t’i udhëheq në karrierën ekzistuese në shtet dhe qeveritë lokale; drejtësia; biznes; organizata ndërkombëtare; shoqëri dhe organizata jofitimprurëse; fushatë menaxhuese dhe fushatë votimi; gazetari; shkollim parauniversitar; politika zgjedhore; kërkime dhe mësim fakultativ.

Studentët e diplomuar në këtë program studimor, do të kenë mundësi të vazhdojnë me studimet e ciklit të dytë (studime të magjistraturës), për t’u kompletuar më tepër me njohuri dhe shkathtësi dhe për të pasur mundësi që të merren me punë kërkimore shkencore.





Përmbajtja e programit dhe struktura

Fakulteti i Administrimit Publik dhe Shkencave Politike ofron një program 3-vjeçar të drejtuar në gradën “Bachelor of Arts” në Politikë dhe Punë Sociale. Ky program studimor fokusohet në debatin kyç të shekullit të 21-të përsa i përket punës dhe politikave sociale, në Maqedoni, Evropë dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Një vëmendje e veçantë do t’i kushtohet debatit për organizimin dhe funksionimin modern të punës dhe politikave sociale dhe mënyrës se si do t’i përmbushin ato nevojat e shteteve, institucioneve publike, shoqërisë, publikut dhe stafeve të ndryshme që i sigurojnë këto shërbime. Zhvillimi i institucioneve të shoqërisë civile do të bëhet realitet vetëm nëse kemi personel kompetentë, të pajisur me aftësi, njohuri dhe kompetenca për të garantuar zhvillimin e shoqërisë moderne.

Rezultatet nga programi mësimor

Studentët pritet të tregojnë dhe të zotërojnë një larmi aftësish, kompetencash dhe njohurish në fusha specifike të punës dhe politikave sociale, të cilat do t’i lejojnë ata të veprojnë me profesionalizëm dhe efikasitet në fushën ku do të punësohen.

Metodologjia e mësimdhënies dhe mësimnxënies

Programi aplikon një përqsasje moderne dhe interaktive të mësimdhënies. Përmbajtja e njohurive është e trajtuar përmes leksioneve, teksteve të punës dhe leximeve të drejtuara. Aktiviteti i studentëve përfshin punën në grup, punën individuale, raste-studimi, zgjidhje problemesh, prezantime dhe punë praktike.

Mundësitë për karrierë

Duke e plotësuar programin e Bachelor of Arts në Politikë dhe Punë Sociale, studentët do të jenë të aftë të mbajnë pozicione sfiduese në qendrat sociale, administratë publike, spitale, qendra të rehabilitimit të kriminelëve, organizata private, institucione edukimi, organizata joqeveritare, kompani të sigurimit social dhe shumë vende pune të tjera interesante.

Punë dhe Politikë Sociale

Titulli i ofruar:
“Bachelor of Arts (BA)”

Fakulteti / Departamenti:
Fakulteti i Administratës
Publike dhe Shkencave
Politike

Kohëzgjatja e studimeve:
3 vite (6 semestra) - 180 kredi

Gjuha e studimeve:
Shqip

Kushtet për aplikim:
shihni konkursin në:
www.seeu.edu.mk

Kontaktet:
tel: +389 44 356 131
fax: +389 44 356 001



Gjuhë dhe Letërsi Shqipe

Gjuhë Angleze me Studime

Gjuhë Gjermane me Studime

Gjuhë dhe Studime Evropiane - Gjermanisht-Shqip

Gjuhë dhe Studime Evropiane - Frëngjisht-Gjermanisht

Titulli i ofruar:
“Bachelor of Arts”

Fakulteti / Departamenti:
Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit

Kohëzgjatja e studimeve:
3 vite (6 semestra) - 180 kredi

Gjuha e studimeve:
Shqip / maqedonisht / anglisht / gjermanisht / frëngjisht

Kushtet për aplikim:
shihni konkursin në:
www.seeu.edu.mk

Kontaktet:
tel: +389 44 356 076
fax: +389 44 356 001

Përmbajtja e programit dhe struktura

Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit ofron drejtime që kanë për qëllim t’i pajisin studentët me shkathtësi dhe njohuri nga fusha të ndryshëm studimi që lidhen me gjuhët, kulturat dhe komunikimin.

Studentët, do të përmirësojnë njohuritë e tyre nga komponentët gjuhësorë të të shkruarit, komunikimit, si dhe aftësi të tjera të fushave që studiojnë. Ato, gjithashtu do t’i përmirësojnë dhe përparojnë njohuritë e tyre në fushën e gjuhësisë, metodologjisë së mësimdhënies, letërsisë, kulturës, civilizimit, si dhe të historisë së gjuhëve të huaja dhe inkorporimin e tyre në fushën e kërkimeve shkencore.

Metodologjia e mësimdhënies dhe mësimnxënies që aplikohet, është në përputhje me standardet ndërkombëtare, e bazuar në llojllojshmërinë e metodave dhe qasjes moderne e interaktive të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Metodologjia e aplikuar e vendos studentin në qendër të vëmendjes, duke e inkurajuar atë që të marrë pjesë aktive gjatë mësimi përmes prezantimeve dhe debateve grupore. Mësimdhënia përfshin pjesëmarrjen në ligjërata, seminare, punime të shkruara (ese) dhe punëtori.

Pas përfundimit të programeve, studentët do të jenë të aftë për të zënë funksione të ndryshme në organizata të ndryshme private, qeveritare dhe joqeveritare, ku kërkohet përdorimi praktik i gjuhëve apo njohurive profesionale përkatëse.

Gjuhë dhe Letërsi Shqipe

Programi studimor Gjuhë dhe Letërsi Shqipe ka për qëllim që në mënyrë të vazhdueshme t’i përgjigjet nevojës për të siguruar një ofertë të mjaftueshme të mësimdhënësve profesionistë (të ardhshëm ose aktualisht në shërbim), të përgatitur mirë.

Gjuhë Angleze me Studime / Gjuhë Gjermane me Studime

Studentët do t’i përmirësojnë njohuritë e tyre nga komponenti gjuhësor i të shkruarit, komunikimit, si dhe aftësi të tjera gjuhësore të gjuhëve që studiojnë. Ata, gjithashtu do t’i përmirësojnë dhe përparojnë njohuritë e tyre në fushën e gjuhësisë, metodologjisë së mësimdhënies, letërsisë, kulturës, civilizimit, si dhe të historisë së gjuhëve përkatëse dhe përfshirjen e tyre në fushën e kërkimeve shkencore.

Gjuhë dhe Studime Evropiane: opsioni Gjermanisht – Shqip

Ky drejtim ka për qëllim që të përgatisë kuadër profesionistë në njohjen e gjuhës gjermane dhe shqipe. Përveç kësaj, të diplomuarit e ardhshëm, do të fitojnë njohuri edhe nga sfera e studimeve evropiane. Ky program, njëkohësisht është edhe bazë e mirë për vazhdimin e studimeve të magistraturës në programet ekzistuese në vend dhe jashtë.

Gjuhë dhe Studime Evropiane: opsioni Frëngjisht - Gjermanisht

Ky drejtim, ka për qëllim që të përgatisë profesionistë në njohjen e gjuhës gjermane dhe frënge, të cilët njëkohësisht do të mund t’u përgjigjen sfidave të shekullit XXI. Të diplomuarit në gjuhë dhe studime evropiane do të kualifikohen: Të diplomuar në gjuhë (frënge dhe gjermane) dhe studime evropiane.



Përkthim dhe Interpretim (Shqip – Maqedonisht)

Ky drejtim, përqendrohet në krijimin e kuadrove profesionale për përkthim dhe interpretim (shqip - maqedonisht dhe anasjelltas), me gjuhë të huaj, duke i marrë parasysh nevojat për ndërtimin e një shoqërie shumetnike dhe afrimit të tyre me rrjedhat evropiane. Studentët do të përgatiten për t'u bërë përkthyes dhe interpretues të gjuhës shqipe dhe maqedonase me gjuhë të huaj. Ata do të kualifikohen për përkthyes-interpretues të diplomuar të gjuhës shqipe dhe gjuhës maqedonase me gjuhë gjermane dhe përkthyes-interpretues të diplomuar të gjuhës shqipe dhe gjuhës maqedonase me gjuhë frënge.

Mundësitë e karrierës

Të diplomuarit do të jenë mirë të përgatitur dhe me njohuri solide për mësimdhënës dhe këshilltarë-drejtues të administratës, në ambasada, organizata joqeveritare, udhëheqës të bizneseve, si dhe projekteve të ndryshme të organizuara nga Unioni Evropian, pastaj në struktura zhvillimore dhe integruese të karakterit ndërkombëtar si: KB, UNICEF dhe institucione të tjera evropiane, në ministri dhe institucione të tjera qeveritare, përkthyes-interpretues në gjykata dhe institucione të tjera të ngjashme etj.

Shkencat e Komunikimit

Programi trevjeçar “Bachelor of Arts” i Drejtimit të shkencave të komunikimit inkuadron studime dinamike interaktive dhe interdisiplinare. Nga këto studime, pritet të gjenerojnë rezultate pozitive të përshtatura me nevojat e tregut global dhe në të njëjtën kohë të shërbejnë si bazë për studime pasuniversitare (cikli i dytë i studimeve).

Mundësitë e karrierës

Pas përfundimit, stë diplomuarit do të jenë në gjendje të punësohen në fusha të tilla si:

- Gazetari (Gazeta, Radio, TV).
- Prodhim mediash.
- Komunikim korporativ (marrëdhënie me publikun, menaxhimin e burimeve njerëzore, shërbimet e zbulimit (shërbimet e inteligjencës), shërbimet e kundërzbulimit).
- Institucionet rregullatorë (ministritë, shërbimet e sigurimit, shërbimet e zbulimit / shërbimet e inteligjencës / shërbimet e kundërzbulimit).
- Institucione të larta të edukimit.
- Gjatë studimeve, studentët kanë mundësi të marrin pjesë në punëtori të ndryshme (work-shop), të organizuara në nivel lokal dhe ndërkombëtar.
- Përparësia e këtij drejtimi është se studentët në semestrin e fundit marrin pjesë në praktikën studentore, nëpërmjet të cilës kanë mundësi të fitojnë përvojë në aspektin aplikativ të shkencave të komunikimit.

Përkthim me interpretim (Shqip-Maqedonisht)

Shkencat e Komunikimit

Titulli i ofruar:
“Bachelor of Arts”

Kohëzgjatja e studimeve:
3 vite (6 semestra) - 180 kredi

Gjuha e studimeve:
Shqip / maqedonisht

Kushtet për aplikim:
shihni konkursin në:
www.seeu.edu.mk

Kontaktet:
tel: +389 44 356 076
fax: +389 44 356 001



CILËSIA NË UEJL

Misioni i Universitetit është:

- të ndjekë përsosmërinë në mësimdhënie dhe hulumtim;
- të jetë i hapur për të gjithë, në bazë të barazisë dhe meritës, pa marrë parasysh përkatësinë etnike;
- në mënyrë aktive të bashkëpunojë me universitetet tjera, në Republikën e Maqedonisë dhe Europën Juglindore si tërësi.

Qëllimi kryesor është:

- të kontribuojë në përdorimin e gjuhës shqipe në arsimin e lartë;
- të promovojë mirëkuptimin ndëretnik;
- të sigurojë qasje shumëgjuhësore dhe multikulturore në mësimdhënie dhe hulumtim;
- të zhvillojë programet studimore me një perspektivë europiane dhe ndërkombëtare.

Synimi ynë është:

- të demonstrojmë zotimin e Universitetit për të arritur dhe për të mbajtur nivel më të lartë të sigurimit të cilësisë në punë dhe menaxhment;
- të arrijmë standarde të brendshme, kombëtare dhe ndërkombëtare;
- të sigurohemi se çdo fakultet, departament dhe ekip ka përmirësim të vazhdueshëm në rrafshin individual dhe kolektiv në përgjegjësitë dhe qëllimet.

Vlerat tona kryesore dhe synimet e përsosshmërisë, barazisë, bashkëpunimit dhe efiçencës do të realizohen përmes:

- rishikimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të mësimnxënies, mësimdhënies, hulumtimit dhe shërbimeve përkrahëse për studentët dhe stafin;
- përdorimit aktiv të planifikimit dhe procesit të vetëvlerësimit lidhur me misionin tonë dhe Planin strategjik;
- zhvillimit dhe përdorimit të komunikimit efektiv dhe punës ekipore pozitive;
- shpërndarjes efektive, funksionimit dhe rishikimit të politikës së cilësisë, si dhe procedurave dhe proceseve;
- zhvillimi i cilësisë së lartë në mësimdhënie dhe i ambientit të punës.

www.seeu.edu.mk

 **Abdikim**

Broshura në fjalë është përgatitur si një udhërrëfyes joformal për lehtësi të studentëve të ardhshëm. Megjithëse informatat e ofruara janë të sakta për kohën e publikimit të broshurës, disa aspekte të programeve dhe praktika e Universitetit mund t'i nënshtrohet disa modifikimeve dhe revizioneve gjatë kohës. Prandaj, Universiteti rezervon të drejtën për t'iu nënshtruar këtyre ndryshimeve në bazë të nevojës. Kështu që, informacionet e paraqitura nga Universiteti gjatë vitit duhet të konsiderohen si (ku duhet), të zëvendësueshme me informacionet e paraqitura në këtë broshurë.



Kontaktet

Universiteti i Evropës Juglindore

Rr. e Ilindenit p.n.
1200 Tetovë
Republika e Maqedonisë
Tel: +389 44 356 000
Fax: +389 44 356 001

Zyra për Informim
Qyteza universitare, ndërtesa 802
Tel: +389 44 356 188
z.tairi@seeu.edu.mk

Zyra për Pranimin e Studentëve
Qyteza universitare, ndërtesa 802
Tel: +389 44 356 090
+389 44 356 091

Zyra për Mbështetje Finansiare
Qyteza universitare, ndërtesa 802
Tel: +389 44 356 044
a.beqiri@seeu.edu.mk

Zyra për Marrëdhënie me Opinionin Publik
Ndërtesa QZHB, kati III
Tel: +389 44 356 113
proffice@seeu.edu.mk

www.seeu.edu.mk

